Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-364
Datë: 02.05.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2025 nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe Validohet** IAAP Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "Austrian Schule" Rr. Gjilanit, kilometri III, Hajvali, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2025 deri 31.08.2028, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1. **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e mësimit njëzetepesë (25) nxënës me një klase, brenda vitit shkollor mund ti regjistroj deri ne 2 klase brenda vitit shkollor.
   1.2. **Teknik Dentar,** Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizoj procesin mësimore deri me njëzetepesë (25) nxënës në një klase, brenda vitit shkollor.

2. Institucioni obligohet të plotësojnë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së IAAP Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "Austrian Schule" ka parashtruar në AKK kërkesë për Akreditim dhe Validim të institucionit për kualifikimet: Bashkëpunëtor Professional te Infermierisë (BPI) dhe Teknik Dentar, Niveli III dhe IV i KKK.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushe veprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për Akreditim dhe Validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjeve së aplikimit, vizitës ne Institucion dhe raporteve për kualifikimet: Bashkëpunëtor Professional te Infermierisë B.P.I., (Shqyrtimi i dokumentacionit: 05-12.02.2025, Vizita në institucion: 14.02.2025 dhe 26.02.2025, Hartimi i raportit vlerësues: 03.03.2025), Teknik Dentar (Shqyrtimi i dokumentacionit: 15.03.2025, Vizita në institucion:18.03.2025, Përpilimi i raportit vlerësues:04.04.2025).

Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 02.05.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/ 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.
Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit IAAP Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "Austrian Schule", për Akreditim dhe Validim, si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- IAAP, Sh.M.L.M "Austrian Schule";
- Arkivit të AKK.



Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Prot. No.: 01-364 Data: 20.05.2025
Datum:
Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Deklarata e pajtueshmërisë ligjore dhe rregullative

Kjo deklaratë duhet të dorëzohet në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve
- **nga ofruesit e akreditуar të cilët dëshirojnë të vazhdojnë akreditimin**
- **nga ofruesit të cilët kërkojnë akreditim si pjesë e aplikacionit**

Deklaratë

Unë, kuptoj që validimi dhe akreditimi nuk e heqin detyrimin e ofruesve që të jenë në pajtim me kërkesat statusore apo kërkesat tjera ligjore.

Unë, kuptoj se ofruesit e akreditуar janë në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

- Ofruesit duhen të marrin masa në mënyrë që të sigurojnë se janë të vetëdijshëm, dhe janë në përputhje me të gjitha kërkesat si ato ekzistuese ashtu edhe ato të reja ligjore.
- AKK do të verifikojnë mostra të rastit gjatë inspektimit, në lidhje me këtë deklaratë; nëse hasin dëshmi të shkeljes statusore apo shkelje të kërkesave tjera ligjore, nga ofruesi do të kërkohet që të parashtrojnë dëshminë e pajtimit/përputhjes të konfirmuar nga autoriteti i duhur rregullativ.
- Çfarëdo shkelje e ligjit apo rregullores do të shqyrtohet me seriozitet nga AKK dhe mund të rezultojë me tërheqjen apo ndërprerjen e akreditimit.
- Çdo shkelje e pandërprerë e ligjit apo rregullores të cilën ofruesi i akreditуar nuk arrin ta rregullon brenda kohës së arsyeshme të njoftimit do të rezultojë në tërheqjen e akreditimit.

Konfirmoj se ofruesi merr përgjegjësi në zbatimin e ligjeve sipas këtyre komponentëve:

Sa i përket sigurisë dhe shëndetit:

Ligji për siguri në punë, mbrojte të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;
Ligji për mbrojtje nga zjarri, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;
Ligji për mbrojte nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;

Sa i përket punësimit:

Ligji i punës, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;

Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve:

Kodi penal i Republikës së Kosovës;
Kodi i drejtësisë për të mitur.

Sa i përket mundësive të barabarta:

Ligji për barazi gjinore, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;
Ligji Kundër Diskriminimit, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj.

Sa i përket të drejtës së autorit:
Ligji për të Drejtat e Autorit, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj.

Unë, konfirmoj që ofruesi i poshtëpërmendur është në përputhje me të gjitha legjislacionet e zbatueshme dhe kërkesat rregullative.

Nënshkrimi:

Emri: FJOLLA BRECA

Pozita: DREJTORESH

Emri i ofruesit: SHMLM „AUSTRIAN SCHULE"

Data e deklarimit: 20.05.2025

SHKOLLA E MESME E LARTË E MJEKËSISË
SH.M.L.M.
Austrian Schule
PRISHTINË